

UDHËZIM
Nr. 1020, datë 25.11.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 757, DATË 30.9.2024, “PËR
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT, VLERËSIMIT DHE MIRATIMIT TË
KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI
TË NDËRMJETËSIMIT NË TREGUN E PUNËS DHE MONITORIMIN E TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar; të nenit 20, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të pikës 5, kreu II, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të planit të veprimeve të “Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 757, datë 30.9.2024, “Për procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe monitorimin e tyre”, pika 5, e nenit 3, të kreut II, ndryshon si më poshtë:

“5. Dokument vërtetues për ngurtësimin e një kapitali si rezervë sigurie për të tretët, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja